



Pratuar / Dateduar Printshen / Prodato Received / Dated		08.09.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Keti-ma Quantity	
SPAINSHCK	6026/2023		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.997/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.997/2023 të datës 17.07.2023 të ankuesit

kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar, ankesa A.nr.997/2023 e datës 01.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i cili kishte aplikuar në konkursin e datës 06.04.2023 të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për grupin "Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike" pozita: "Zyrtar i Misionit Diplomatik", ka parashtruar ankesë me datë 01.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokoll: 4560/2023, kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve të datës 30.06.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me pretendimin ankimor se Komisioni Vlerësimit nuk e ka vlerësuar drejtë ankuesin në intervistën me gojë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 19.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli me datë 25.07.2023 ka pranuar përgjigje me shkresat e lëndës, mirëpo me qëllim të plotësimit të tyre me datë 21.08.2023 i është drejtuar Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me kërkesën për prova shtesë.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 24.08.2023 Kryetari i këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 me numër protokolli:5804/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit me shifër A.nr.997/2023 të datës 17.07.2023 i ka shtyrë afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj lëndë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli:5257/2023 e datës 17.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e ankuesit të datës 16.07.2023 dërguar në Këshill; E-mailin e datës 11.07.2023 dërguar nga SIMBNJ për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.07.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 25.07.2023; Vendimin e datës 10.05.2023 të Qeverisë së republikës së Kosovës; Aplikacionin e ankuesit të datës 04.05.2023; Konkursin e shpallur të datës 06.04.2023; Diplomën e datës 02.05.2006 me numër:26; Shkrsën e datës 06.07.2000 lëshuar nga Institut d'Etudes Politiques de Paris; Shkresën e datës 25.02.2002 lëshuar nga UNMIK; Shkresën e datës 08.06.2009 lëshuar nga Univesite Paris 8; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i datës 20.05.2013; Diplomën e datës 28.05.2010; Shkresën e lëshuar nga Assemblée Nationale e datës 10.10.2000; Shkresën e datës 09.01.2004; Kontratën e datës 25.02.2016; Pasqyrën e llogarisë së trustit e datës 02.05.2023; Çertifikatën e datës 02.05.2023 lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Çertifikatën e lëshuar nga Komuna e Pejës e datës 02.05.2023; Çertifikatën shëndetësore të datës 03.05.2023; Formularin e renditjes përfundimtare (pa datë të nxjerrjes); Njoftimin e datës 30.06.2023 lëshuar nga DMZP/MPB; E-mailin e datës 21.08.2023 dërguar nga Këshilli për DMZP;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes konkursit të datës 06.04.2023 ka shpallur konkursin-pranim për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", në kuadër të grupimit "Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike", në të cilin konkurs sipas shkresave të lëndës konstatohet se kishte aplikuar edhe ankuesi Arton Ahmetaj, mirëpo sipas raportit të renditjes përfundimtare të datës 29.06.2023 dhe Njoftimin të datës 30.06.2023 rezulton si njëjti nuk është kandidatë i suksesshëm.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës shtetërore me datë 29.06.2023 ka hartuar Raportin e renditjes përfundimtare sipas së cilit ankuesi ka arritur 66.4, ndërsa dy kandidatët e tjerë kanë arritur numrin e pikëve të nevojshme për të qenë kandidatët të suksesshëm, respektivisht kandidati A.M ka arritur gjithsej 71.2 pikë, kurse kandidati tjetër I.S ka arritur gjithsej 77.2 pikë dhe po ashtu Komisioni i Pranimit me datë 29.06.2023 ka nxjerrë vendimin me shifër:1041/2023 për përfundimin e procedurës së rekrutimit me vlerësimit përkatëse, ndërsa Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit me datë 30.06.2023 e ka njoftuar ankuesen lidhur me piket e arritura nga i njëjti me këshillën juridike: *kandidati i pakënaqur me rastin e vlerësimit përfundimtar, ka të drejtë ankesë të Komisioni Pranimit në afat prej (3) ditëve nga dita e pranimit të këtij njoftimi* dhe po ashtu me datë 11.07.2023 përmes sistemit elektronik simbnj@rks-gov.net e kanë njoftuar ankuesin me shpalljen e kandidatëve të suksesshëm me këshillën e dhënë juridike për të ushtruar të drejtën ankimore pranë KPMSHCK-së sikurse parashihet me nenin 31 paragrafi 1 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovë.

Me qëllim të verifikimit të lejueshmërisë të ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës sikurse përcaktohet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet"* ndërlidhur me nenin 31 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo"*, nga rrjedh se në bazë të konstatimit të gjendjes faktike sikurse në arsyetimin e këtij vendimi, ankuesi kundër njoftimit të datës 30.06.2023 lidhur me vlerësimet përfundimtare të dërguar nga Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit nuk ka parashtruar ankesë të brendshme, pavarësisht faktit se njoftimi i dhënë e përbante këshillën e dhënë juridike sikurse përcaktohet me nenin 25 paragrafin 5 dhe 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"* konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 01.06.2023 është e palejuar pasi që ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se i njëjti ka parashtruar ankesë të brendshme kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve respektivisht kundër Njoftimit të datës 30.06.2023 sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 25 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ndërlidhur me nenin 31 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të së njëjtës rregullore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka pasur parasysh e-mailin e datës 11.07.2023 të dërguar nga institucioni që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit përmes sistemit elektronik simbni@rks-gov.net ku ankuesi ishte njoftuar lidhur më listën e kandidatëve të suksesshëm me këshillën e dhënë juridike për të ushtruar të drejtën ankimore pranë KPMSHCK-së, mirëpo ky njoftim është standard apo obligim që duhet përbushur nga Komisioni i Pranimit, respektivisht njësia përgjegjëse që zhvillon procedurat e rekrutimit i udhëzon palët që të parashtrojnë ankesë në KPMSHCK në përfundim të procedurës së rekrutimit, mirëpo sikurse u theksuar edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi ankimi pranë KPMSHCK tek këto raste është i lejuar vetëm pas shterimit të brendshëm të mjeteve ankimore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.997/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së